



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:086472

Datë: 09.02.2024

Numri i dokumentit: 05306542

P.nr.732/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm Penal- gjyqtari Lulzim Hoxha, me bashkëpunëtoren profesionale Afërdita Kicaj, në çështjen penale kundër të akuzuarit: B. (A.) I., nga fshati Bukosh, Komuna e Vushtrisë, për shkak të veprës penale: mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së, nr. 06/L-074, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, PP/II.nr.690-9/22 të datës 19.07.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit të Prokurorisë Themelore në Prizren Labinot Jetishi, i dëmtuari Maliq Kryezi, i akuzuari B. I., dhe mbrojtësit të tij sipas detyrës zyrtare Av.A.K., , me datë 08.02.2024, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

B. I., nga i ati A., e ëma, e lindur, i lindur me datënnë fshatin Balincë, Komuna e Vushtrisë, me banim në fshatin Bukosh, Komuna e Vushtrisë, ka të kryer 4 vjet shkollën fillore, me profesion bujk, i martuar, baba i dy fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar në bazë të numrit personal:të lëshuar nga MPB.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 16.10.2020, në kohë të pacaktuar, në Prizren, rr. “William Volker”, saktësisht në shtëpinë e të dëmtuarit M.K., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, për ti sjell vetës apo personit tjetër ndonjë dobi pasurore, e mashtron ose e sjell personin tjetër në lajthim dhe me këtë e shtytë të veproj në dëm të pasurisë së tij, në atë mënyrë që i pandehuri përmes rrjetit social “facebook” shpall njoftim për shitje me foto të një gjedhe (lopë) me ngjyrë bardhë e zi, dhe ka vendosur nr. e telefonit kontaktues të tij, i dëmtuari kontakton me telefon dhe bie dakord me të pandehurin që t’ia sjell në vendin e lartcekur dhe ti paguaj shumën 1000€ (njëmijë euro), ditën kritike i pandehuri e sjell në gjedhe tjetër me ngjyre kuq e bardhë, i dëmtuari vëren se nuk është gjedhja për të cilën janë marrë vesh, kërkon nga ai që t’ia sjell gjedhen për të cilën janë d akorduar, por i pandehuri arsyetohet se gjedhja për të cilën janë marrë vesh është me barrë dhe pas insistimit të pandehurit, i dëmtuari d akordohet që ta blej lopën të cilën e ka sjellë, ku i paguan shumën 730€ (shtatëqind e tridhjetë euro) dhe të nesërmen pas dyshimeve nga i dëmtuari se gjedhja është e sëmurë, dhe pas kontrollit nga veterinari merr vesh që gjedhja është e sëmurë, e ka mishin të infektuar dhe nuk guxon të konsumohet dhe e njëjta nuk ka shërim, për të cilin fakt nuk ka qenë në dijeni i dëmtuari , i cili edhe pas tentimit që i pandehuri t’ia kthej të hollat ose t’ia ndërroj gjedhen, i njëjti nga ajo ditë

e deri më tani nuk i përgjigjet dhe pas tre muajve të tentimeve të pa suksesshme të shërim, të dëmtuarit i ngordhë gjedhja, me ç 'rast i shkakton dëm material në shumën e lartcekur.

Me këto veprime, ka kryer veprën penale: mashtrimi, nga neni 323 par.1 të KPRK-së nr. 06/L-074.

Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 4, 7, 8, 9,17, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 50, 69, 70, 71,72, të KPRK-së, si dhe nenit 364 KPPRK-së,

Të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME GJOBË

- Në shumën prej katërqind euro (400,00 €), për veprën penale si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, , të cilin dënim me gjobë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në dy (2) këste mujore, duke filluar nga data 01 deri 05 të çdo muaji vijues, dhe atë në afat prej 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Nëse i akuzuari B. I., nuk mund apo nuk dëshirojnë ta paguajë dënimin me gjobë në shumën e lartcekur, atëherë gjykata konform nenit 43 par. 3 të KPRK-së, dënimin me gjobë, do t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € llogaritet 1 (një) ditë burgim, gjithsej 20 ditë burgim.

Si dhe:

DËNIMIN ME KUSHT

- Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej një (1) viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.
- Në qoftë se i akuzuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim prej dy (2) apo më tepër vjet i njëjti do të revokohet.
- I dëmtuari me adresë si në shkresat e lëndës për realizimi e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil-juridik.
- OBLIGOHET i akuzuari B. I., që ti kompensoj shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare, duke përfshirë të gjitha shpenzimet, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej (20) njëzet euro, në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej (20) njëzet euro, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor.
- Urdhërohet Shërbimi Sprovues i Kosovës - dega në Prizren, që të bëjë mbikëqyrjen e dënimit me kusht

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm Penal, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzë nën numrin PP/II.nr.690-9/22, e datës 19.07.2022, kundër të akuzuarit: B. (A.) I., nga fshati Bukosh, Komuna e Vushtrisë, për shkak të veprës penale: mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së, nr. 06/L-074.

Duke vepruar në këtë çështje penale, gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar më datë 07.02.2024, në të cilin i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së lartcekur.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe konform dispozitave të nenit 241 e 242 të KPP-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

I akuzuari B. I., deklaron se: e ka të qartë aktakuzën dhe e pranon fajësinë sipas pikave të aktakuzës.

Avokati mbrojtës deklaron se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë.

Prokurori i shtetit deklaroj se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë.

I dëmtuari deklaron se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, mirëpo parashtron kërkesë pasurore – juridike.

Palët heqën dorë nga seanca mbi caktimin e dënimit.

Në shqyrtimin fillestar, gjykata, pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin të ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë, në këtë aspekt, i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata në shqyrtim fillestar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datën 16.10.2020, në kohë të pacaktuar, në Prizren, rr. “William Volker”, saktësisht në shtëpinë e të dëmtuarit M.K., me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, për ti sjell vetës apo personit tjetër ndonjë dobi pasurore, e mashtron ose e sjell personin tjetër në lajthim dhe me këtë e shtyt të veproj në dëm të pasurisë së tij, në atë mënyrë që I pandehuri përmes rrjetit social “facebook” shpall njoftim për shitje me foto të një gjedhe (lopë) me ngjyrë bardhë e zi, dhe ka vendosur nr. e telefonit kontaktues të tij, i dëmtuari kontakton me telefon dhe bie dakord me të pandehurin që t’ia sjell në vendin e lartcekur dhe ti paguaj shumën 1000€ (njëmijë euro), ditën kritike i pandehuri e sjell në gjedhe tjetër me gjyrë kuq e bardhë, i dëmtuari vëren se nuk është gjedha për të cilën janë marrë vesh, kërkon nga ai që t’ia sjell gjedhën për të cilën janë dakorduar, por i pandehuri arsyetohet se gjedhja për të cilën janë marrë vesh është me barrë dhe pas insistimit të pandehurit, i dëmtuari dakordohet që ta blej lopën të cilën e ka sjellë, ku i paguan shumën 730€ (shtatëqind e tridhjet euro) dhe të nesërmen pas dyshimeve nga i dëmtuari se gjedhja është e sëmurë, dhe pas kontrollit nga veterinari merr

vesh që gjedhja është e sëmurë, e ka mishin të infektuar dhe nuk guxon të konsumohet dhe e njëjta nuk ka shërim, për të cilin fakt nuk ka qenë në dijeni i dëmtuari, i cili edhe pas tentimit që i pandehuri t'ia kthej të hollat ose t'ia ndërroj gjedhën, i njejtë nga ajo ditë e deri më tani nuk i përgjigjet dhe pas tre muajve të tentimeve të pa suksesshme të shërim, të dëmtuarit i ngordhë gjedhja, me ç'rast i shkakton dëm material në shumën e lartcekur.

Me këto veprime, ka kryer veprën penale: mashtrimi, nga neni 323 par.1 të KPRK-së nr. 06/L-074.

Gjykata, gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë prej të akuzuarit, i cili në seancën e shqyrtimit fillestar vullnetarisht e ka pranuar fajësinë, andaj gjykata nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare, gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme sipas nenit 251 të KPPK-së.

Gjithashtu, në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Kësisoj, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 240 lidhur me neni 242, dhe se në veprimet e të akuzuarit B. (A.) I., nga fshati Bukosh, Komuna e Vushtrisë, për shkak të veprës penale: mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së, dhe për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo-juridike.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69, 70, 71.72 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese, gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimin për rastin e ndodhur, kërkim faljen dhe i premtoj gjykatës se nuk do të përsëris veprime të tilla kundërligjore. Ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori për bazë, veprën penale të kryer, niveli i dëmtimit të vlerës së mbrojtur, mënyrën e kryerjes së veprës penale, shkallën e lartë të dashjes, veprimi me përgjegjësi, ku i akuzuari me dashje ka mashtruar të dëmtuarit duke shkakuar tek i dëmtuarit dëm material, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me gjobë dhe dënim me kusht, sepse konsideron se me këtë masë sanksionuese do të arrihet qëllimi i dënimit, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla kundërligjore.

Gjykata vendimin e ka mbështetur duke u bazuar edhe në neni 38 i KPK-së i cili konsiston në *“parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëj rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcim detyrimit për respektimin e ligjit”*.

- Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 para. 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së).

- Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt civil është marrë në pajtim me nenin 462 par. 1. dhe 2. të KPPK-së.
- Vendimi mbi kompensimin e viktimave të Krimit, gjykata e mori në kuptim të nenit 36 parag.3 pika 3.1 të Ligjit me numër 08/L-109. ku thuhet “*për veprën penale që gjykohej në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore shuma është prej njëzet (20) Euro*”.

Nga të cekurat si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.732/22, të datës 08.02.2024

B. Profesionale,
Afërdita Kicaj

Gjyqtari,
Lulzim Hoxha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 30 dite nga dita e pranimit të të njëjtit, ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet të kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2022:086472
Datë: 09.02.2024
Numri i dokumentit: 05306542